



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 597/4 Prot.

Tiranë, më 28 / 06 / 2021

V E N D I M

Nr. 113, Datë 28 / 06 / 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 58, datë 07.04.2021, të E. M, ku pretendohet diskriminim për shkak të “gjinisë” dhe “çdo shkak tjetër”¹ nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, E. M, në ankesën e sjellë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), pretendon se është diskriminuar nga ana e punëdhënësit të saj, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD).

Në parashtrimet e saj, ankuesja shprehet se, ka lidhur marrëdhëniet e punës me DPD në vitin 2006 dhe më pas, në vitin 2010 është transferuar në detyrën e juristes, pranë Degës së Doganës Durrës. Në vitin 2019 ka përfituar statusin e Nëpunësin Civil, të cilin e gëzon dhe aktualisht. Nëpërmjet Urdhrit me nr.536 prot., datë 12.01.2021 të DPD ankuesja është transferuar në detyrë të përkohshme, nga Sektori i Administratës dhe Shërbimit pranë Degës së Doganës Durrës, në Sektorin Teknik pranë Zyrës Juridike në DPD.

Me datë 13.01.2021 ankuesja ka kundërshtuar transferimin e saj, për shkak të distancës të vendit të punës mbi 45 km nga vendbanimi i saj (fshati Qerret/Kavajë). Bazuar në shpjegimet dhe aktet bashkëlidhur ankesës², rezulton se, pallati ku ka banuar ankuesja në lagjen nr.17, Durrës, për shkak të dëmeve që ka pësuar nga tërmeti i datës 26.11.2019, është shpallur i pabanueshëm dhe aktualisht ajo banon me qira në një banesë në fshatin Qerret, Kavajë. Në

¹ Në rastin konkret ankuesja nuk ka përcaktuar një karakteristikë apo veçanti që mbart dhe që prezumohet që ka ndikuar në kryerjen e sjelljes diskriminuese të pretenduar.

² Vendim i Këshillit Bashkiak Durrës.

momentin e transferimit të saj nga Dega e Doganës Durrës në DPD ajo rezulton banuese në fashin Qerret, Kavajë dhe distanca që i duhet të përshkojë për të vajtur në vendin e punës është rreth 56 km vajtje dhe 56 km në kthim. Në këto kushte ka kundërshtuar pranë punëdhënësit transferimin e saj dhe duke qenë se nuk ka marrë përgjigje, me datë 12.02.2021 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, e cila me Vendimin nr. 46, datë 12.02.2021 vendosi “*pranimin e kërkesës së E. M, pezullimin e ekzekutimit të Urdhrit nr. 536 prot., datë 12.01.2021 të DPD, deri në një vendim të formës së prerë nga gjykata*”.

Ankuesja me datë 02.03.2021, ka depozituar pranë DPD vendimin sipërcituar, për ekzekutim. Duke mos marrë asnjë përgjigje nga ana e DPD, ka kërkuar në mënyrë të përsëritur ekzekutimin e vendimit gjyqësor, lidhur me pezullimin e transferimit të saj në DPD, vendim i cili dhe aktualisht nuk është zbatuar nga ana e punëdhënësit.

Ankuesja ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë krahasuar me kolegët e tjerë meshkuj, të cilët, rreth një javë pas transferimit të përkohshëm, janë rikthyer në vendet e tyre të mëparshme të punës, duke cituar respektivisht emrat e punonjësve: K. C, G. Ç, A. D, J. M, P. K. Këtë trajtim të pabarabartë ankuesja e lidh me gjininë e saj si femër, dhe në këtë kontekst ka pretenduar se DPD e ka diskriminuar atë, duke e vënë në pozita të pafavorshme krahasuar me kolegët meshkuj, pikërisht për shkak të gjinisë.

Në përfundim, subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e DPD, si dhe marrjen e masave për ndreqjen e pasojeve të shkaktuara, duke e rikthyer në detyrën e mëparshme, pranë Degës Doganore Durrës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Në nenin 3/1, të ligjit 10221/2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, parashikohet se “*Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*”.

Ligji nr. 10221/2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, ka parashikuar në nenin 7/1 “*Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që*

marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Në nenin 12/1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, (LMD) parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Bazuar në nenin 32/1/a, të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr. 597/1 prot., datë 13.04.2021 i është kërkuar informacion dhe dokumentacion mbështetës DPD, lidhur me ankesën e subjektit ankues.

Komisioneri paraprakisht informoi DPD, lidhur me faktin që, nëse prej tyre do të ndërmerreshin masa pozitive lidhur me përmbushjen e kërkesës së ankueses, duke e rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, në Drejtorinë e Doganës Durrës, Komisioneri do të ndërpriste procedurën hetimore, duke e konsideruar të zgjidhur rastin³.

Me shkresën me nr. 6882/1 prot., datë 04.05.2021, DPD, ka depozituar pranë KMD-së parashtrimet e veta lidhur me pretendimet e ankueses, si dhe ka bashkëlidhur dokumentacion provues.

Nëpërmjet shkresës me nr.10048/1 prot., datë 08.06.2021, DPD, informoi Komisionerin se, në vijim të komunikimit në lidhje me ankesën e E. M, ka zbatuar Vendimin nr. 46, datë 12.02.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Durrës, duke e rikthyer atë në detyrën e mëparshme “Specialiste”, në Sektorin e Administratës Doganore, Dega Doganore Durrës. Në këtë kontekst, gjukojmë se DPD, se ka përmbushur njëherësh edhe kërkesën e Komisionerit për marrjen e masave për ndreqjen e pasojave.

DPD ka bashkëlidhur Urdhrin nr. 10048 nprot., datë 04.06.2021 “Për rikthimin në detyrën e mëparshme”, i cili urdhëron:

^{3 3} Përmes marrjes dijani të kësaj shkrese, subjekti ankues ishte njohur me këtë kërkesë të KMD-së.

- “E. M, aktualisht e transferuar me detyrë “Specialiste”, Sektori Teknik, Drejtoria Juridike, të rikthehet në vendin e punës me detyrë “Specialiste”, Sektori i Administratës Doganore, Dega Doganore Durrës.
- Pagesa t’i bëhet sipas kategorisë III-b.
- Puna që do të kryejë, të jetë në përputhje me përshkrimin e punës, bashkëlidhur këtij Urdhri.
- Ky Urdhër hyn në fuqi me datë 07.06.2021”.

2. Nëpërmjet e-mailit të datës 11.06.2021, subjekti ankues, ka informuar Komisionerin se:

“Në vijim të ankesës drejtuar Institucionit Tuaj, ju bëj me dije se nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, subjekti ndaj të cilit kam bërë ankesë për diskriminim, është përmbushur detyrimi ligjor për rikthimin tim në detyrë sipas Vendimit nr. 46, datë 12.02.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, përmes Urdhrit “Për rikthim në detyrën e mëparshme”. Aktualisht është përmbushur detyrimi i kërkuar pranë Jush”.

Neni 90, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative (K.P.A), ka parashikuar se:

“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Komisioneri, vëren se, qëllimi për të cilin dhe është iniciuar procedura hetimore, është përmbushur gjatë kohës së shqyrtimit të çështjes pranë KMD-së, dhe se kryerja e mëtejshme e veprimeve administrative nga ana e Komisionerit ka humbur aktualitetin, në kushtet e përmbushjes së kërkesës së ankueses për rikthimin në pozicionin e mëparshëm.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet e ndryshimit të rrethanave: faktike dhe ligjore, është përmbushur kërkesa e ankueses për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës.

Për rrjedhojë është përmbushur edhe qëllimi i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për sigurimin e të drejtës së çdo personi për:

- “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;*
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;*
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.*

Për sa më sipër, bazuar në Urdhrin sipërcituar, si dhe konfirmimin e faktit të rikthimit në vendin e punës me detyrë “Specialiste”, Sektori i Administratës Doganore/Dega Doganore Durrës, të E. M; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se kërkesa e subjektit ankues është plotësuar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 9, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe nenit 90, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative të nisur, lidhur me shqyrtimin e ankesës së subjektit ankues E. M, kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: “Gjinia”, “çdo shkak tjetër”.

Lloji i vendimit: Arritje efektiviteti